829
01.08.2024

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3435/1 Prot Elbasan më 31 /07/2024

# VENDIM

Nr 70 datë 30 /07/2024.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin QERSHOR 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin QERSHOR 2024, 59 familje me fond 172.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** ________
**Pro**____________
**Kundër**____________
Abstenim__________

3435/2
08.08.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 829/1 Prot

Elbasan, më 08.08.2024

**Lënda**: Konfirmim akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.70, datë 30.07.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Qeshor 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.054252138 www.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

830
01.08.2024

3/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.3434/1 Prot Elbasan më 31 /07/ 2024

**VENDIM**
Nr. 71 datë 30 /07/2024

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **QERSHOR 2024** gjithsej 219 familje me një fond prej 956.864 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë ____________**
**Pro____________**
**Kundër____________**
**Abstenim____________**

3434/2
08.08.2024.


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**


80 VJETORI I ÇLIRIMIT

**Nr.** 830/1 **Prot** **Elbasan, më** 08.08**.2024**

**Lënda**: Konfirmim akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.71, datë 30.07.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qeshor 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**
**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

831

01.08.2024

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3154/3 Prot                                                  Elbasan më 31.07.2024

**VENDIM**

**Nr. 72, Datë 30.07.2024**

"Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Ali Mysliu"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 30.07.2024, mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronjat "b" dhe "c" dhe pika 5, të nenit 54 shkronja "j" dhe të nenit 55 pika 3 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore":

**VENDOSI**

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Elbasan, Z. Ali Mysliu, përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste, për arsye të dorëheqjes nga mandati.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar datë 30.07.2024
Pro ___
Kundër____
Abstenim____

Konc. L. Guri

**SEKRETARI**

**Elvi Çuni**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

3154/4
12.8.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr 831/1 Prot.

Elbasan më 12.8. 2024

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.72 datë 30.07.2024 "Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Ali Mysliu", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

832
01.08.2024

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3649/1 Prot                                                  Elbasan më 31.07.2024

**VENDIM**

**Nr. 73 , Datë 30.07.2024**

"Për krijimin e Komisionit të Përkohshëm Hetimor të Këshillit Bashkiak Elbasan"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", dhe të Rregullores së Përgjithshme të Këshillit Bashkiak Elbasan Neni 39-43 të tij:

**VENDOSI**

1. Të miratojë krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm hetimor të Këshillit Bashkiak Elbasan sipas listës bashkangjitur:

   1. Erion Murataj - Kryetar
   2. Ilirjan Sadiku - Nënkryetar
   3. Doris Madhi - Sekretare
   4. Bjanka Copja
   5. Enerieta Ferra
   6. Indrit Abdiaj
   7. Esmeralda Mallosi

2. Objekti i hetimit të këtij Komisioni do të jetë:
   - Hetimin e logjistikës së mjeteve të punës në Drejtorinë e ASHP.
   - Zbatueshmëria e rregullave të sigurisë në punë objekt i përditshmërisë në ASHP.

3. Afati i vlefshmërisë së këtij komisioni do të jetë 2 muaj.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc. L. Guri

**SEKRETARI**
**Elvi Çuni**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

3449/2
12.08.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 832/1 **Prot.** **Elbasan më** 12.8 **.2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.73 datë 30.07.2024 "Për krijimin e Komisionit të Përkohshëm Hetimor të Këshillit Bashkiak Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ali Mysliu**

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

833
01.08.2024

4

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENCIA E KULTURES DHE TURIZMIT**

**VENDIM**

**Nr.3465/1 Prot.** **Elbasan31.07.2024**

**Nr.74 datë:30.07.2024**

***Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit***
***Znj. Ilirjana Haxhiu.***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij, të datës30.07.2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit, Znj. Ilirjana Haxhiu,* mbështetur në nenin 54(gërma"m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore"(i ndryshuar), si dhe në nenin 15(pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

5. Ti jape titullin, "Qytetar Nderi" i Elbasanit, Znj.Ilirjana Haxhiu , me motivacionin:
6. **"Për kontributin e dhënë me shumë përkushtim në fushën e inxhinierisë dhe ndërtimit në sektorin publik dhe privat të Bashkisë dhe Qarkut Elbasan".**
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Elvi Çuni**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

*Konc. D.Dyrmishi , D.Kristo*
*Drejtoria Juridike: A. Hoxha*
*Drejtor i përgjithshëm i A.K.T: A.Guni*

3462/2.
08.08.2024.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 833/1 prot.

Elbasan, më 08.08.2024

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.74 datë 30.07.2024, “Për vlerësimin me titullin ‘Qytetar Nderi i Elbasanit’ znj. Ilirjana Haxhiu (pas vdekjes)” , konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

839
01.08.2024

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr 3466/1 prot                                                    Elbasan me 31. 07. 2024

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

**VENDIM**

**Nr. 75, datë 30/07/2024**

**PËR**

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË QË TI BASHKOHET DHE TË FIRMOSË MARREVESHJEN E KRYETARËVE TE BASHKISË PËR KLIMËN DHE ENERGJINË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË**

Në mbështetje të Ligiit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligj nr. 155/2020 për ndryshimet klimatike, Ligji nr. 53/2020 për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, të Paktit të Kryetarëve të Bashkive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, për anëtarësimin e Kryetarit të bashkisë për firmosjen e Klimën dhe Energjinë dhe hartimin e Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe luftimin e ndryshimeve klimatike veprimit për energjinë dhe klimën e qëndrueshme (SECAP-it) si dhe në kudër të bashkëpunimit ndëristitucional të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Organizatave Shqipëtare dhe të huaja.

**VENDOSI:**

1. Të Autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan që t'i bashkohet dhe të nënshkruajë Marrëveshjen e Kryetarit për Klimë dhe Energji, për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.
2. Të ngarkojë Drejtorinë e Integrimit Europian Projekteve dhe Donatorëve për ndjekjen e proçedurave të regjistrimit të përfshirjes së kryetarit në konventen e Kryetarëve të Bashkive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqise për Klimën dhe Energjinë

Konceptoi: P.S.P.D — K.Kreka
Pranoi: D.D.I.E.P.D — K.Qosja
D.J.I — A.Hoxha
Miratoi: D.P.P.ZH — S.Mehmeti

Sekretari i Keshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetar i Keshillit Bashkiak
Lutfi LALA

Covenant of Mayors
for Climate & Energy
EUROPE

Bashkia Elbasan

Nr_______prot                                                                 Elbasan: me____/____/____

**Konventa e Kryetarëve të Bashkive – Evropë**

Rritja e veprimeve për një Evropë më të drejtë dhe neutrale ndaj klimës

Ne, kryetarët e bashkive nga e gjithë Evropa, rrisim ambiciet tona për klimën dhe angazhohemi për të kryer veprime me ritmin që dikton shkenca, në një përpjekje të përbashkët për të mbajtur rritjen e temperaturës globale nën 1.5°C - ambicia më e lartë e Marrëveshjes së Parisit.

Prej vitesh tashmë, qytetet i kanë kthyer sfidat klimatike dhe mjedisore në mundësi. Ka ardhur koha për ta bërë atë prioritetin kryesor.

Si nënshkrues të Paktit të Kryetarëve të Bashkive - Evropë, ne synojmë t'i përfshijmë të gjithë në këtë rrugëtim. Ne do të sigurohemi që politikat dhe programet tona të mos lënë askënd dhe asnjë vend prapa.

Tranzicioni në një Evropë neutrale ndaj klimës do të ketë ndikime në të gjitha fushat e shoqërive tona. Si udhëheqës lokalë, ne duhet të mbajmë një sy vigjilent mbi ato ndikime për të siguruar drejtësi dhe gjithëpërfshirje. Ne mund të parashikojmë vetëm një tranzicion që është i drejtë, gjithëpërfshirës dhe respektues për ne qytetarët e botës dhe për burimet e planetit tonë.

Vizioni ynë është që deri në vitin 2050, ne të gjithë do të jetojmë në qytete të dekarbonizuara dhe elastike me akses në energji të përballueshme, të sigurt dhe të qëndrueshme. Si pjesë e lëvizjes Konventa e Kryetarëve të Bashkive - Evropë, ne do të vazhdojmë (1) të reduktojmë emetimet e gazeve serrë në territorin tonë, (2) të rrisim qëndrueshmërinë dhe të përgatitemi për ndikimet negative të ndryshimeve klimatike dhe (3) të trajtojmë varfërinë energjetike si një veprim kyç për të siguruar një tranzicion të drejtë.

Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se të gjitha shtetet anëtare të BE-së, rajonet dhe qytetet janë në faza të ndryshme të tranzicionit të tyre dhe secila ka burimet e veta për t'iu përgjigjur ambicieve të përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit. Ne e pranojmë edhe një herë përgjegjësinë tonë kolektive për të trajtuar krizën klimatike. Sfidat e shumta kërkojnë një përgjigje të fortë politike në të gjitha nivelet e qeverisjes. Pakti i Kryetarëve të Bashkive - Evropa është, para çdo gjëje tjetër, një lëvizje kryebashkiakësh të përkushtuar që ndajnë zgjidhjet lokale dhe frymëzojnë njëri-tjetrin në synimin për të arritur këtë vizion.

Ne angazhohemi të bëjmë pjesën tonë duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

1. ANGAZHOHUNI për të vendosur objektiva afatmesme dhe afatgjatë, në përputhje me objektivat e BE-së dhe të paktën po aq ambicioze sa objektivat tona kombëtare. Qëllimi ynë do të jetë të arrijmë

neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Duke marrë parasysh emergjencën aktuale të klimës, ne do të bëjmë prioritet veprimin ndaj klimës dhe do t'ua komunikojmë atë qytetarëve tanë.

2. ANGAZHOJMË qytetarët, bizneset dhe qeveritë tona në të gjitha nivelet në zbatimin e këtij vizioni dhe në transformimin e sistemeve tona sociale dhe ekonomike. Ne synojmë të zhvillojmë një pakt lokal klimatik me të gjithë aktorët që do të na ndihmojnë të arrijmë ato objektiva.

3. VEPRONI, tani dhe së bashku, për të hyrë në rrugën e duhur dhe për të përshpejtuar tranzicionin e nevojshëm. Ne do të zhvillojmë, zbatojmë dhe raportojmë - brenda afateve të përcaktuara, një plan

veprimi për të arritur objektivat tona. Planet tona do të përfshijnë dispozita se si të zbuten dhe të përshtaten me ndryshimet klimatike, duke mbetur gjithëpërfshirëse.

4. RRJETI me kolegë kryetarë bashkie dhe drejtues lokalë, në Evropë dhe më gjerë, për të marrë frymëzim nga njëri-tjetri. Ne do t'i inkurajojmë ata që të bashkohen me ne në lëvizjen e Paktit Global të Kryetarëve të Bashkive, kudo që të jenë në botë, nëse do të përqafojnë objektivat dhe vizionin e përshkruar këtu.

Ne, nënshkruesit e Paktit të Kryetarëve të Bashkive - Evropë, pohojmë se mund të ndërmarrim hapa sot (Përkushtimi, Angazhimi, Veprimi, Rrjeti) për të siguruar mirëqenien e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. Së bashku, ne do të punojmë për ta kthyer vizionin tonë në realitet.

Ne llogarisim në mbështetjen e qeverive tona kombëtare dhe të institucioneve evropiane për të siguruar politika, burime teknike dhe financiare që i përshtaten nivelit të ambicieve tona.

**KRYETARI I BASHKISE ELBASAN**

**Gledian LLATJA**

**Mandatuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi LALA**

**Më date [ ]/[ ]/[ ].**

**NËNSHKRIMI ZYRTAR**

Covenant of Mayors
for Climate & Energy
EUROPE

Bashkia Elbasan

No_______prot    Elbasan: on____/____/____

**Covenant of Mayors – Europe**

Stepping up action for a fairer, climate-neutral Europe

We, Mayors from all over Europe, hereby **step up our climate ambitions and commit to delivering action** at the pace that science dictates, in a joint effort to keep global temperature rise below 1.5°C - the highest ambition of the Paris Agreement.

For years already, cities have been turning **climate and environmental challenges into opportunities. Time has come to make it the overarching priority.**

As signatories to the Covenant of Mayors - Europe, we commit to taking everyone on this journey. We will make sure that our policies and programmes will leave no one and no place behind.

The transition to a climate-neutral Europe will have impacts in all areas of our societies. As local leaders, we must keep a watchful eye on those impacts to ensure fairness and inclusiveness. **We can only envisage a transition that is fair, inclusive and respectful of us citizens of the world, and of our planet's resources.**

**Our vision is that, by 2050, we will all be living in decarbonized and resilient cities with access to affordable, secure and sustainable energy**. As part of the Covenant of Mayors - Europe movement, we will continue to (1) reduce greenhouse gas emissions on our territory, (2) increase resilience and prepare for the adverse impacts of climate change, and (3) tackle energy poverty as one key action to ensure a just transition.

We are fully aware that all EU Member States, regions and cities are at different stages in their transition, and each have their own resources to respond to the ambitions set out in the Paris Agreement. We acknowledge once again our collective responsibility to tackle the climate crisis. The numerous challenges require a strong policy response at all levels of governance. The Covenant of Mayors - Europe is, before anything else, a movement of committed Mayors who share local solutions and inspire each other in the view to achieve this vision.

We commit to doing our share by undertaking the following actions:

1. **COMMIT** to setting mid- and long-term targets, consistent with the EU objectives, and at least as ambitious as our national targets. Our goal will be to achieve climate neutrality by 2050. Considering the current climate emergency, we will make climate action our priority and communicate it to our citizens.

2. **ENGAGE** our citizens, businesses and governments at all levels in the implementation of this vision and in the transformation of our social and economic systems. We aim to develop a local climate pact with all the players who will help us reach those objectives.

3. **ACT,** now and together, to get on track and accelerate the necessary transition. We will develop, implement and report -within the established deadlines, an action plan to reach our targets. Our plans will include provisions on how to mitigate and adapt to climate change, while remaining inclusive.

4. **NETWORK** with fellow Mayors and local leaders, in Europe and beyond, to get inspiration from each other. We will encourage them to join us in the Global Covenant of Mayors movement, wherever they are in the world, would they embrace the objectives and vision described herein.

We, signatories to the Covenant of Mayors - Europe, affirm that we can take steps today (**Commit, Engage, Act, Network**) to ensure the well-being of present and future generations. Together, we will work to turn our vision into reality.

We count on the support of our national governments and the European institutions to provide policy, technical and financial resources that fit the level of our ambitions.

Mandated by the Mayor of Municipal Council

Lutfi LALA

on [dd]/[mm]/[yyyy].

OFFICIAL SIGNATURE

***

***

The Covenant of Mayors - Europe Office is funded by the European Commission.

3466/2
14.08.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 839/1 **Prot.** **Elbasan më** 12.8.**2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.75 datë 30.07.2024 "Për dhënien e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë që ti bashkohet dhe të firmosë marrëveshjen e Kryetarëve të Bashkisë për klimën dhe energjinë për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali Mysliu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

835
01.08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKRETARIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.3530/1.Prot.** **Datë 31. .07. 2024**

**VENDIM**

**NR.76. DATË 30 . 07 . 2024**

**MBI**
**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PËRCAKTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE PUBLIKE PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË TË BASHKISË ELBASAN"**

Këshilli Bashkiak, pasi shqyrtoi relacionin e administratës së Bashkisë mbi përdorimin e teknollogjisë së inovacionit në administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 8, 9, 23, 32, 35, dhe 54, ligjin 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", neni 7, pika 1(f) dhe pika 8, si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 35, me propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratohet shërbimi i parkimit me pagesë orare, në rrugë dhe sheshe publike të bashkisë Elbasan.
2. Shërbimi i parkimit me pagesë orare është shërbimi i ofruar për rregullimin e parkimit të automjeteve në qytet, ku qëndrimi i automjeteve kushtëzohet nga pagesa e një tarife (shume) që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit në parkim.
3. Të miratohen zonat në rrugët dhe sheshet publike të Bashkisë Elbasan si dhe fashat orare ku do të realizohet shërbimi i parkimit me pagesë, sipas Tabelës nr.1 dhe (hartës) bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Identifikimi i zonave të parkimit me pagesë në rruget dhe sheshet publike do të bëhet nëpërmjet vizimit me ngjyrë BLU dhe/ose tabelave vertikale sinjalizuese për zonën e destinuar për shërbimin e parkimit me pagesë.
5. Tarifa e shërbimit të parkimit me pagesë do të jetë në masën e parashikuar në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak
6. Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë të kryhet nëpërmjet sistemeve elektronike të teknollogjisë së informacionit, të ofruara nga subjekte të liçensuara
7. Aplikimi i sistemit të pagesës së parkimit të kryhet nëpërmjet aplikacionit "Elba-Parking" që do të ofrohet pa pagesë për të gjithë qytetarët.
8. Furnizimi i qytetarëve me kredite për parkim do të bëhet nga subjekte tregtare të interesuara që zhvillojnë aktivitetin e tyre në ose pranë zonës së parkimit kundrejt pagesës së tarifës parashikuar në pikën 5 të këtij vendimi, kundrejt përfitimit të 5 % të vlerës për të cilën bëhet furnizimi me kredite. Marrdhënjet ndërmjet Bashkisë dhe subjekteve tregtare që ofrohen të kryejnë këtë shërbim, do të rregullohen me marrëveshje midis tyre.

9. Ngarkohen Drejtoria e Transportit Publik, Sektori i Transportit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Finacës, me zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimi i Kwshillit Bashkiak nr 60 datw 18.06.2020, shfuqizohet
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

ANEKSI 1

## Rruget e sheshet publike ne te cilat do te ofrohet sherbimi i parkimit me pagese.

| **Rruget** | **Te sugjeruara per parkim me pagese** |
|---|---|
| 1.Rruga (Bulevardi "Aqif Pasha") | Segmeniti nga Stadjumi deri te Ura e Zaranikes, ne drejtim te perendimit ne krahun e majte |
| 2.Rruga "Qemal Stafa" | Segmenti nga Kryq.RR,Q.Stafa me rrugen K.Sejdini deri Muzeu etnog. ne drejtim te perendimit ne krahu djathte. |
| | Segmenti nga Drejtoria e Tatimeve deri te rreth rrotullimi postes, dy krahet. |
| 3.Rruga "Thoma Kalefi" | Segmenti nga rreth rrotullimi I Bashkise deri te Unaza ne dy krahet. |
| 4. Rruga "Janaq Kilica" | Segmenti nga Nje maji deri te lulishtja para bashkise ne drejtim te jugut krahu i majte.( Para hamamit) |
| 5.Rruga "Kozma Naska" | Segmenti prej Paralel me lulishten deri te kryqezimi me rrugen Aqif Pasha. |
| 6.Rruga "28 Nentori" | Segmenti nga kryqezimi rruges Muc Shqiptari, para policise me rrugen 28 nentori deri te rreth rotullimi spitalit, ne drejtim te veriut, krahu i majte. |
| 7.Rruga "25 Nentori" (e Treni) | Ne dy krahet |
| 8.Rruga "Rinia" | Segmenti nga Universiteti Aleksandder Xhuvani deri te kryqezimi me rrugen Aqif Pasha, ne drejtim te jugut ne krahun e majte. |
| | |
| **Sheshet** | |
| 1.Zona Sheshi prapa pallatit sportit | Pallati e Sportit, pjesa qendres, prapa pallatit. |
| 2.Zona te "Kinemaja vullnetari" | Shesh i vogel ne te per pak mjete |
| | |

Koha e funksionimit të parkimit me pagesë do të jetë:

| Zona e vendparkimeve me pagesë | Orari i funksionimit Dite jave (Hene Premte) |
|---|---|
| 1.Rruga Aqif Pasha | 08:00 – 20:00 |
| 2.Rruga Qemal Stafa | 08:00 – 16:00 |
| 3.Rruga Thoma Kalefi | 08:00 – 16:00 |
| 4. Rruga "Janaq Kilica" | 08:00 – 16:00 |
| 5.Rruga "Kozma Naska" | 08:00 – 16:00 |
| 6.Rruga "28 Nentori" | 08:00 – 16:00 |
| 7.Rruga 25 nentori (e Trenit) | 08:00 – 16:00 |
| 8.Rruga Rinia | 08:00 – 16:00 |
| 4 Sheshet | 08:00 – 16:00 |

E Shtuna e Diela do të jetë pa pagesë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin !

| | |
|---|---|
| *Sek trans* | *E. Bordi* |
| *Drejt IT* | *E. Hoxha* |
| *Drejt Taksave* | *K. Çullhaj* |
| *Drejt finances* | *A. Merkja* |
| *Drejtoria Juridike* | *A. Hoxha* |

**Sek. K. Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari**
**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA ELBASAN -

3530/3.
08.08.2024.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 835/1 prot.                                                  Elbasan, më 08.08.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 *"Për Prefektin e Qarkut"*, të ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 76 datë 30.07.2024 *"Për miratimin e kritereve dhe përcaktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë të Bashkisë Elbasan"*, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.
Akti juaj të zbatohet duke respektuar të gjitha proçedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë lidhje dhe veprojnë në këtë fushë të veprimtarisë duke ju sjellë në vëmendje, referuar pikës 5 vendimmarrjes tuaj, faktin që kjo tarifë të përfshihet në vendimin e Këshillit bashkiak për taksat dhe tarifat e Bashkisë Elbasan.

**PREFEKTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**Ali Mysliu**

Lagja "Brig.17 Sulmuese", Rr."Qemal Stafa" Tel.054252138, www.prefektielbasan.gov.al , prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 3530/2. Prot. Elbasan, më 5.08.2024

**Vendim**
**Nr 77 Datë 30/07/2024**
**Për miratim marrëveshje**

Këshilli Bashkiak, në mbledhejn e tij të datës 30/07/2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe draft marrëveshjen e paraqitur nga administrata e Bashkisë, në lidhje me pagesën e tarifës orare të parkimit publik me pagesë, midis Bashkisë Elbasan dhe subjekteve që ofrohen për të kryer këtë shërbim, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 8, 9, 23, 54 të tij

Vendosi

1- Të miratojë akt-marrëveshjen tip, që do të lidhet midis Bashkisë dhe subjekteve tregtarë që ofrohen për të kryer shërbimin e vjeljes së tarifës orare të parkimit publik, nëpërmjet furnizimit me kredite në aplikacionin "Elba-Parking, sipas tekstit bashkangjitur
2- Subjektet sipas pikës 1, për shërbimin e kryer të përfitojnë 5% të shumës së arkëtuar për mbledhjen e tarifës orare të parkimit.
3- Ngarkohen Drejtoria e Transportit Publik, Sektori i Transportit, , Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Juridike, me zbatimin e këtij vendimi.
4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

*Sek trans E. Bordi*
*Drejt IT E. Hoxha*
*Drejt Taksave K. Çullhaj*
*Drejtoria Juridike A. Hoxha*

**Sek. K. Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari**
**Lutfi Lala**

3530/4
13.08.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

**Nr.** 889/1 **Prot.** **Elbasan më** 13.8. **2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.77 datë 30.07.2024 "Për miratim marrëveshje", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

836
01.08.2024

7

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3550/1 Prot.

Datë 31 .07. 2024

# VENDIM

**NR. 78 DATE 30 . 07. 2024**

**MBI**

**"Transferim i fondeve për shpenzime në buxhetin e vitit 2024, në zërin investime"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .07.2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Transferim i fondeve për shpenzime, në zërin investime"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.01.2024 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.126, datë 26.12.2023, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", i ndryshuar,

## VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2024, nga të ardhurat, për Bashkinë dhe njësitë vartëse, si më poshtë :

**Paksohet :**

| | |
|---|---|
| 800,000 lekë | "Shpenzime për rinovim liçensa Firewall", funks. 01110, artikulli 602, Bashkia; |
| 800,000 lekë | "Shpenzime për CAL për user për active directory", funks. 01110, artikulli,602 |
| 95,572 lekë | "Shpenzime energji elektrike", funksioni 01110, artikulli 602, Bashkia. |
| 4,900,000 lekë, | shpenzime "Kuote anëtarësie K.Qarkut", funksioni 01110, artikulli 604, Bashkia (tepricë limiti) |
| 100,000 lekë | shpenzime "energji elektrike", funksioni 01110, artikulli 602, Bashkia |
| 280,000 lekë | supervizim "Rikonstruksion dhe rivitalizim i tregut Fruta-Perime",(tepricë prok.) funksioni 04160, artikulli 231, Bashkia; |
| 213,000 lekë | supervizim "Ndërtim i shkollës "Jonuz Çarçiu", fshati Tregan", (tepricë prok.) funksioni 09120, artikulli 231, Bashkia; |
| 639,041 lekë | tepricë prokurimi : "Restaurim i Qendrës Rinore dhe Këshillimit të Karrierës", funksioni 09120, artikulli 231, Bashkia; |
| **7,827,613 lekë** | **gjithsej** |

**Shtohet :**

| | |
|---|---|
| 1,600,000 lekë , | "Blerje Enterprise Next Generation Firewall", funksioni 01110, artikulli 231, njësia shpenzuese Bashkia. |
| 85,332 lekë , | supervizim "Restaurim i plotë i Muzeut Etnografik", funksioni 08220, artikulli 231, njësia.shpenzuese AKT. |
| 10,240 lekë, | kolaudim " |
| 6,132,041 lekë , | "Rikonstruksion objekte arsimore, viti 2024 (hidroiz, riparime)", funksioni 09120, artikulli 231, njësia.shpenzuese QEA. |
| **7,827,613 lekë** | **gjithsej** |

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë dhe Drejtoria e Prokurimeve.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Elvi Çuni**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA ELBASAN

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja

Dr.Juridike: A.Hoxha

3550/2.
12.08.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 836/1 **Prot** **Elbasan, më** 12.8.**2024**

**Lënda**: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.78, datë 30.07.2024 "Mbi transferim i fondeve për shpenzime në buxhetin e vitit 2024, në zërin investime", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542ë138 www.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 3592/2 **Prot.** **Elbasan, më** 31.07.**2024**

**VENDIM**
**Nr** 79 **Datë** 30/07/**2024**

**Mbi dhënjen e të drejtës së shfrytëzimit(pa pagesë) të pasurive me emërtimin Stadiumi " Elbasan Arena", A.F Elbasanit Sh.a"**

